

VERSIONI PUNUES

REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
Miraton:

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-050 PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË GJITHË PERSONAT ZYRTARË

Neni 1

Në Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë për të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (më tej ligji), në titullin e ligjit fjala “personat zyrtarë” zëvendësohet me fjalën “zyrtarët e lartë publik” dhe në tërë tekstin e ligjit fjala “personi zyrtar” zëvendësohet me fjalët “zyrtar i lartë publik”.

Neni 2

1. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.4 pas fjalës “Kryeshefat e Agjencive” shtohen fjalët “apo pozitat e barazvlefshme” si dhe pas fjalës “tjetër” shtohen fjalët “dhe zëvendësit e tyre”.

2. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.6 pas fjalës “Publike” shtohen fjalët “Kryeshefat, Zëvendës Kryeshefat, sekretarët e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe lokal”.

3. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.8 fshihen fjalët “Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale” .

4. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.11 ndryshohet si vijon: “Drejtorët apo Udhëheqësit apo menaxheret e të gjitha Departamenteve, Drejtorive apo Drejtorateve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike”.

5. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.13 pas fjalëve “prorektorët e Universitetit Publik” shtohen fjalët “anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik”.

6. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nën-nënparagrafi 1.1.18 pas fjalës “kryeinspektorët” shtohen fjalët ”dhe zëvendës kryeinspektorët”.

7. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pas nën-nënparagrafit 1.1.18 shtohen dy nën-nënparagrafët e ri si vijon:

“1.1.19. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor”

“1.1.20. gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri si dhe Ministrat, e që nuk përmendën shprehimisht me këtë ligj.”

8. Në nenin 3 të ligjit, paragrafi 1.2 ndryshohet si vijon: “**Anëtarët e familjes** – bashkëshortët, bashkëjetuesi dhe fëmijët me të cilët zyrtari jeton në një bashkësi familjare”.

9. Në nenin 3 të ligjit, paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 ndryshohen si vijon: “Të gjithë ushtruesit e detyrës në pozitat e lartpërmendura (nga paragrafi 1.1.1 deri 1.1.20) janë të obliguar të deklarojnë pasurinë.”

Neni 3

1. Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 2 fjala “institucion” zëvendësohet me fjalën “zyrtar kontaktues”.

2. Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 2.2 pas fjalës “njofton” shtohet fjala “me shkrim”.

3. Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 2.3 pas fjalës “Agjencia” shtohen fjalët “nga data 1 mars”.

Neni 4

1. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 1.2 ndryshohet si vijon “1.2. e tërë pasuria e luajtshme në vlerë mbi tremijë (3000) Euro”

2. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 1.4 pas fjalës “me vlerë” shtohen fjalët “dhe pjesët e kapitalit në zotërim”

3. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 1.5 ndryshohet si vijon:

“1.5. para të gatshme, në llogari rrjedhëse, në depozita, në bono thesar dhe në huadhënie në euro ose në valuta tjera të huaja;

4. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 1.6 para fjalës “detyrime” shtohen fjalët “të drejtat dhe”

5. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 ndryshohet si vijon:

“1.7. të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale”

6. Në nenin 5 të ligjit, paragrafi 2 fshihet ndërsa paragrafi 3 rinumërohet si paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 5

Në nenin 6 të ligjit, paragrafët 2 dhe 3 fshihen.

Neni 6

1. Në nenin 8 të ligjit, paragrafi 1 pas fjalës “kalendarik” shtohen fjalët “për vitin paraprak nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor”.

1. Në nenin 8 të ligjit, paragrafët 2 dhe 3 fshihen.

Neni 7

Në neni 10 të ligjit, paragrafi 2 fshihet.

Neni 8

1. Në nenin 11 të ligjit, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri si vijon:

“3. Dhurata të rastit konsiderohen dhuratat e vogla me vlerë deri në pesëdhjetë (50) Euro, vlera e përgjithshme e të cilave nuk kalon mbi 100 Euro nëse janë dhënë nga i njëjti person. Zyrtari nuk mund të pranojë dhurata të rastit vlera e përgjithshme e të cilave kalon mbi 500 Euro brenda vitit “ ndërsa paragrafi 3 bëhet 4 dhe vazhdon rinumërimi deri në fund të nenit.

2. Në nenin 13 të ligjit, paragrafi 3 pas fjalës “dhuratë” shtohet fjala “të rastit”.

3. Në nenin 13 të ligjit, paragrafi 3 pas fjalës “monetare” shtohen fjalët “letra me vlerë dhe metale të çmuara pa marrë parasysh vlerën e tyre”

4. Në nenin 13 të ligjit, paragrafi 5 pas fjalës “dhuratën” shtohen fjalët “për regjistrim të zyrtari kontaktues i institucionit përkatës”

Neni 9

1. Në nenin 12 të ligjit, paragrafi 1 pas fjalës “personave” shtohen fjalët “apo institucioneve”.

2. Në nenin 12 të ligjit, paragrafët 4 dhe 5 fshihen ndërsa paragrafi 6 rinumërohet si paragrafi 4 dhe vazhdon rinumërimi deri në fund të nenit.

Neni 10

Neni 13 i ligjit ndryshohet si në vijim:

**“Neni 13
Publikimi**

1. Agjencia publikon formularët e deklarimit të pasurisë në afatin prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e kalimit të afatit për deklarimi të pasurisë.
2. Nuk publikohen të dhënat nga formulari të cilët janë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”

Neni 11

Neni 14 i ligjit ndryshohet si në vijim: “Agjencia është institucion qendror për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.”

Neni 12

1. Në nenin 15 të ligjit, paragrafi 4 pas fjalës “formular” shtohen fjalët “dhe krahasimin e të dhënave me formularë paraprak”
2. Në nenin 15 të ligjit pas paragrafit 4 shtohen paragrafët si vijon:
“5. Kur gjatë kontrollit të plotë zbulohet se deklarimi nuk është i saktë ose burimi i deklaruar nuk identifikohet dhe nuk mbulon pasuritë e deklaruara, Agjencia kërkon nga zyrtari për të dhënë shpjegime dhe argumente përkatëse të cilat paraqiten me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
6. Kontrollit të plotë çdo vit i nënshtrohen jo më pak se 20 % e formularëve”

Neni 13

Në nenin 16 të ligjit pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri:

“5. Agjencia ka të drejtë të ftoj ekspertë të pavarur të fushave të ndryshme që të bëjë vlerësimin e pasurive ose për çështje tjera të arsyeshme.”

Neni 14

Neni 17 i ligjit ndryshohet si vijon:

“Neni 17

1. Agjencia ushtron kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit të lartë publik i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2. Për inicimin e procedurës penale, Agjencia e njofton udhëheqësin e institucionit në të cilin zyrtari i lartë publik punon ose ka punuar.

3. Agjencia publikon emrat e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë deklaruar gjendjen e pasurisë apo dhuratave ashtu siç është paraparë me ligj”

Neni 15

Neni 18 i ligjit fshihet dhe vazhdon rinumërimi i neneve deri në fund të ligjit.

Neni 16

Neni 19 i ligjit ndryshohet si vijon

“Të gjitha procedurat për vepra kundërvajtëse të cilat janë iniciuar sipas ligjit deri me 01.01.2013 zgjidhen sipas dispozitave të ligjit.”

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.